

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ME SELI NË BULQIZE**  
**“ B.V.B“Sh.p.k.**

Sot, më datë 13.01.2021 (dymije e njezetenje), ortaku themelues:

**Zj. Albina Durici**, shtetas shqiptar, e bija e Bilal, lindur ne Martanesh me 17.09.1985, dhe banues ne Bulqize, ne adresën rruga “Lagja Gjeologu” zona kadastrale 8612 nr.pasurie 2/119/3 me karte identiteti nr I55917009A dhe

**Z.Myfit Durici** shtetas shqiptar, e biri e Naim, lindur ne Bulqize me 05.04.1970, dhe banues ne Bulqize, ne adresën rruga “Lagja Gjeologu” zona kadastrale 8612 nr.pasurie 2/119/3 me karte identiteti nr H00405009B :

Vendosen themelimin e shoqërisë “ **B.V.B “Sh.p.k.** përmes ketij akt-themelimi

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “ **B.V.B “Sh.p.k.** themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë **Shoqëria**).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “ **B.V.B “Sh.p.k.** Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria ka per objekt veprimtarie:

- Bar kafe

**NENI 4**

**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulqize Rruga Gjeologu Ne zonen kadastrale 8612, nr.pasurie 2/119/3 Bulqize,Shqipëri.

*Alv*

*M. J. J.*

## **NENI 5**

### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para te ortakevet themelues. Kontributi në para do të ketë vlerën prej 100.000,00 (njëqindmije) Lekë.

Ortaket themelues te Shoqërisë zotërojnë një kuotë në shoqëri si më poshtë:

**Zj. Albina Durici**, shtetas shqiptar, e bija e Bilal, ne cilesine e ortakut themelues, zoteron 49% te vleres se kapitalit themeltare te shoqerise te barabarte me 1(nje) kuote ne vlerë prej 49.000 (dyzetenentemije) Leke. dhe

**Z.Myfit Durici** shtetas shqiptar, e biri e Naim, ne cilesine e ortakut themelues, zoteron 51% te vleres se kapitalit themeltare te shoqerise te barabarte me 1(nje) kuote ne vlerë prej 51.000 (pesedhjetenjemije) Leke. dhe

Kapitali themeltar është derdhur në total nga ortaket themelues. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortaket me miratimin e këtij Akti.

## **NENI 6**

### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i pa përcaktuar.

## **NENI 7**

### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administrator i Shoqërisë do të jetë:

**Zj. Albina Durici**, shtetas shqiptar, e bija e Bilal, lindur ne Martanesh me 17.09.1985, dhe banues ne Bulqize, ne adresën rruga “Lagja Gjeologu” zona kadastrale 8612 nr.pasurie 2/119/3 me karte identiteti nr I55917009A

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, përpjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

##### **Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

#### **NENI 12**

##### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjate aktivitetit te shoqerise zgjidhen me konsensus, ne te kundert palet i drejtohen gjykates kompetente.

#### **NENI 13**

##### **Dispozita Përfundimtare**

Akti i themelimit përpilohet në tre kopje të njëjtë në gjuhën shqipe.

ORTAKET THEMELUES  
“B.V.B“Sh.p.k.

**Albina Durici**



**Myfit Durici**

